V E N D I M
Nr. 399, datë 22.8.2002

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.34, DATË 7.1.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE DHE TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa;

1.Në fund të pikës 11 të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Këtë trajtim e përfitojnë Presidenti i Republikës dhe Kryeministri, për periudhën nga dita e emërimit deri në fillimin e detyrës".

2.Në fund të pikës 15 të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Ish-Presidentit, ish-Kryeministrit dhe ish-Kryetarit të Kuvendit, për periudhat kohore, respektive, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, sipas mundësisë, u siguron mjedise të domosdoshme pune, kundrejt tarifave të caktuara nga kjo drejtori".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano